

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                          |
|---------|------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Gjermani/ CDU fiton zgjedhjet komunale në Saksoninë e Poshtme - Shqiptarja.com           |
| ADRESA  | https://shqiptarja.com/lajm/gjermani-cdu-fiton-zgjedhjet-komunale-ne-saksonine-e-poshtme |
| BURIMI  | shqiptarja.com                                                                           |
| GJENDJA | edited                                                                                   |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 14 shtator 2026, 19:22:56 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 19:15:27 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | a80afee89f09e838d9baeca9f46f77da42fe6bb11000610f8c932f9a38dcc9bb |
| TEKSTI     | b99819d7ff4947264cedb7159be617d587857e98cd3bfb98c825640a0d07203f |
| PAMJA      | e8ced20e7859555a5a7a26d13c5fa275dde0321f02dc80a06eac8cf5e611b78  |

## ZINXHIRI I PROVËS

|                |                                                                                                                                                                    |
|----------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE      | d46906853225076f84f7fd479b72b99f6a6ef3c2c8784843dac662c138d54b00                                                                                                   |
| E MËPARSHMJA   | 9bbaca5a4fa65c3bb51c74e369ddcd8e27d000b0454f2fc2f54e1d4e7b65e873                                                                                                   |
| RRËNJJA MERKLE | —                                                                                                                                                                  |
| ANKORIMI       | nuk është ankoruar ende<br><i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d46906853225076f84f7fd479b72b99f6a6ef3c2c8784843dac662c138d54b00>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Vizita në SHBA, Rama me diasporën në Michigan: S'jemi më vend mbijetese, por shprese! Objektivi ynë, BE në 2030! Kryeministri merr dedikimin e veçantë (VIDEO)

Bota

## Gjermani/ CDU fiton zgjedhjet komunale në Saksoninë e Poshtme

Pjesëmarrja në votime arriti në 64,6 për qind, duke shënuar një rritje të konsiderueshme. Pesë vjet më parë kishin votuar 57,0 për qind e qytetarëve me të drejtë vote. Këtë herë, rreth 6,3 milionë persona kishin të drejtën të mermin pjesë në zgjedhje.

■ AFD fitoi zgjedhjet rajonale, kancelari Merz përjashton dorëheqjen: Rusia po gëzohet, CDU u trondit në themel



Numërimi i votave në Saksoninë e Poshtme



Redaksia

14 Shtator, 21:13 | Përditësimi: 14 Shtator, 21:42


f Share Tweet

A A

Në zgjedhjet komunale në Saksoninë e Poshtme, CDU-ja ka dalë sërish forca më e madhe politike dhe ka zgjeruar epërsinë e saj ndaj SPD-së. AfD-ja renditet në vendin e tretë.

Mes debateve rreth kancelarit federal Friedrich Merz, pas humbjes në landin Saksoni-Anhalt, CDU-ja është bërë forca më e madhe politike në zgjedhjet komunale të landit të Saksonisë së Poshtme (Niedersachsen). Në nivel qarqesh, ajo arriti në 27,2 për qind të votave. Sipas rezultatit paraprak të publikuar në portalin zgjedhor të landit, SPD-ja mori 24,6 për qind.

AFD-ja shënoi rritje dhe arriti në 15,9 për qind. Të Gjelbrit morën 14,1 për qind, E Majta (Die Linke) 6,0 për qind, ndërsa FDP-ja 3,7 për qind.



LEXO EDHE:

Putini nuk ka nevojë të fitojë në Ukrainë për të fituar në Evropë

Pjesëmarrje e lartë në zgjedhje

Në zgjedhjet e mëparshme për qarqet, të mbajtura në vitin 2021, CDU-ja kishte dalë forca më e madhe me 31,7 për qind, e ndjekur nga SPD-ja me 30,0 për qind. Të Gjelbrit kishin arritur 15,9 për qind, FDP-ja 6,5 për qind, AfD-ja 4,6 për qind, ndërsa E Majta (Die Linke) 2,8 për qind. Rritjen më të madhe e ka shënuar AfD-ja, duke arritur rezultatin më të mirë ndonjëherë në zgjedhjet komunale në Saksoninë e



Poshtme. Nderkohë, CDU-ja dhe SPD-ja kanë humbur mbështetje krahasuar me zgjedhjet e mëparshme.

Pjesëmarrja në votime arriti në 64,6 për qind, duke shënuar një rritje të konsiderueshme. Pesë vjet më parë kishin votuar 57,0 për qind e qytetarëve me të drejtë vote. Këtë herë, rreth 6,3 milionë persona kishin të drejtën të merrnin pjesë në zgjedhje.

#### "Kemi vënë re pakënaqësinë ndaj Berlinit"

Kryetari i CDU-së në Saksoninë e Poshtme, Sebastian Lechner, u shpreh optimist që disa orë para publikimit të projeksioneve të para se partia e tij do të dilte forca më e madhe në rang të landit. Ai tha se ishte i bindur se CDU-ja e landit mund të shkëputej nga tendenca negative në nivel federal dhe se kishte një shans shumë të mirë të bëhej sërish forca kryesore politike në Saksoninë e Poshtme. "Ju e dini se këto zgjedhje komunale nuk janë zhvilluar në rrethana të lehta. Edhe ne e kemi vënë re pakënaqësinë ndaj Berlinit", tha Lechner, duke iu referuar klimës politike në nivel federal. Kryetari i SPD-së në Saksoninë e Poshtme dhe njëherazi kryeministri i landit, Olaf Lies, e cilësoi rezultatin e zgjedhjeve si të vështirë për partinë e tij: "Kishim shpresuar të gjithë për më shumë se kaq." Me këtë deklaratë, Lies pranoi zhgënjimin brenda SPD-së për rezultatin e arritur në zgjedhjet komunale./DW

R.Xh/Shqiptarja.com

TAG: AfD gjermani Saksoni zgjedhjet ne gjermani CDU

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★ 5.0 / 5 (1 vlerësim)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH

### Sondazhi i ditës: Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?

16 Shtator, 14:18

Të drejtë Të gabuar Nuk e di

## Lajme të tjera



Exit-poll 'trondit' Gjermaninë, partia e Merz me rënie drastike! AfD forcë e parë në Mecklenburg-Borpommern perëndimore, në Berlin e Majta

20 Shtator, 19:01



Zgjedhjet në Gjermani, sot mbahet beteja për Berlinin! Votimi rajonal që mund t'i kushtojë Friedrich Merz-it postin e kancelarit



Mara Gergolet

20 Shtator, 11:05



Gjermania do të përdorë inteligjencën artificiale për të zbuluar mashtrimet e emigrantëve me ndihmat sociale

18 Shtator, 17:45



Analiza/ Friedrich Merz përballë krizës politike në Gjermani, humbjet zgjedhore dhe rënia e popullaritetit shtojnë pikëpyetjet, a do ta braktisë CDU-ja kancelarin?



Jens Thureau

18 Shtator, 10:10



'UÇK-ja nuk ishte në gjyq' Franca dhe Gjermania reagojnë pas vendimit të Hagës: Aktgjykimi nuk shfajëson krimet e regjimit jugosllav

16 Shtator, 20:01



Analiza: Pse partitë e konsoliduara në Gjermani po humbasin votuesit migrantë

15 Shtator, 15:18



### Thoma Gëllçi: Pas meje, mbylleni derën



Thoma Gëllçi

14 Shtator, 18:15



### BE ka dhënë 1.1 milionë leje qëndrimi për shqiptarët në Gjermani, numri arrin rekordin e 124 mijë

14 Shtator, 07:00



### Pensionistët në lindje të Gjermanisë kanë më pak pasuri dhe të ardhura se ata në perëndim

12 Shtator, 19:23



### Suedia paralajmëron: Rusia po përdor mijëra llogari të rreme për të ndikuar zgjedhjet në Europë, në shënjestër Gjermania dhe Franca!

11 Shtator, 17:36



### Merz i akuzoi për 'spastrimin etnik', ekstremistët e AfD ngrenë padi penale ndaj kancelarit gjerman

11 Shtator, 16:30



### Sherri kundër Brazilit dhe Kombëtarja e minifutbollit pa mbështetjen e FSHF-së, trajneri Sejko për Report TV: Në Botëror pa doktor



Ernest Koçi

11 Shtator, 13:05

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptaria.com]

Kërko



© 2011 - 2026 Shqiptaria.com - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.